



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:108671

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874717

KPPP.nr.744/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit SE-Fa Hurriyet Mh. Menekse 2 Cd nr.44 Istanbul, përfaqësuar sipas autorizimit nga Liman Musa, avokat nga Ferizaji, kundër debitorit “The North Unicorn” L.L.C., me NUI:810112186, me seli në Prishtinë, Zona Industriale, rruga “Aziz Abrashi”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.213/2022, të datës 21.04.2022, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “The North Unicorn” L.L.C., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.213/2022, i datës 21.04.2022, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të përpilimit të prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën prej 104.00 € (një qind e katër euro), në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.213/2022, të datës 21.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.SEF2020000001354 e datës 28.11.2020, me të cilin është urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumë prej 250.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën

definitive, shpenzimet e procedurës përbarimore, si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përbarim në lartësi prej 104.00 €. Përbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë, dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në pagesën definitive.

Debitori në prapësimin e paraqitur ka theksuar se propozimi për përbarim është mbështetur në faturë në gjuhë të huaj e cila nuk është në asnjërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë, e cila për debitorin është e pakuptueshme dhe se e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore sipas UA nr. 15/2010 për zbatimin e ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat, ngase nuk është e nënshkruar as e vulosur nga debitori. Më tej, ka shtuar se debitori ka kryer pagesa në vazhdimësi për kreditorin dhe atë në lartësi prej 5,000.00 € dhe sikurse fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri të jetë e vërtetë, përsëri nuk i plotëson kushtet ngase nuk mund të jetë në vlerën e kërkuar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar, urdhri përbarimor P.nr.213/2022 të shfuqizohet dhe të detyrohet kreditorit që debitorit t'ia paguaj shpenzimet në emër të prapësimin në lartësi prej 104.00 €, sipas tarifës së avokatëve.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pabazuara dhe të pambështetura në prova. Më tej, ka theksuar se kreditori ka kërkuar nga debitori përmbushjen e obligimit sipas faturës mirëpo që nuk ka hasur në mirëkuptim të debitorit dhe rrjedhimisht është detyruar që të inicioj procedurë përbarimore. Ndërsa, në raport me pretendimet e debitorit për pagesat e kryera, kreditori ka theksuar se të njëjtat pagesa kanë të bëjnë me fatura tjera nga kjo mbi të cilën është iniciuar procedura përbarimore. Ka shtuar se asnjëra nga kushtet për anulimin e urdhrin nuk ekzistojnë pasi që urdhri është nxjerr konform dispozitave të LPP-së, dhe se fatura mbi të cilën mbështetet propozimi për përbarim i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përbarimor P.nr.213/22 të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shumën prej 208.00 €, në emër të paraqitjes së përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike lidhur me këtë çështje përbarimore me Aktvendimin KPPP.nr.486/23 të datës 31.07.2023 e ka hedhë poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr1476/23 të datës 24.04.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit, e ka anuluar Aktvendimin KPPP.nr.486/23 të datës 31.07.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe e ka kthyer lëndën në rivendosi në Gjykatën Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit dhe kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet për shkak të si në vijim:

Sipas nenit 29, par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr.SEF202000001354 e datës 28.11.2020, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori pasi që e njëjta nuk është nënshkruar e as vulosur dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbartim.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe CMR-të, si dokumente ndërkombëtare për mënyrën e transportit të mallrave, të cilat janë të nënshkruara dhe vulosura nga debitori, mirëpo gjeti se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport me ekzistimin e

kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga fatura. Andaj meqenëse procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, gjykata kufizohet vetëm në vlerësimin e elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e prapësimit dhe atë në shumën prej 104.00 € siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.744/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

\KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.